



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1045/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Hatixhe Ahmeti kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Skenderajt, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vitisë, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.1045/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Hatixhe Ahmeti kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Skenderajt, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Skenderajt, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në Vendvotimet 2116B/03D, 2116B/02R, 2116B/01R, 2107B/03R, 2107B/04D.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1045/2021 të paraqitur nga Hatixhe Ahmeti kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Skenderajt, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Skenderajt, me të cilën pretendon se në vendvotimet 2116B/03D, 2116B/02R, 2116B/01R, 2107B/03R, 2107B/04D, ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Hatixhe Ahmeti kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Skenderajt, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Skenderajt, me të cilën kërkon rinumërim të votave në vendvotimet e lartcekura është i pa bazuar.

Pas kërkimeve rezulton se ne këto qëndresa votimi 2116B/03D, 2116B/02R, 2116B/01R, 2107B/03R, 2107B/04D del se pretendimet nuk qëndrojnë pasi që ne këto qendra votimi ka 7 vota ndërsa ka vetëm 3 dëshmitar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, ankuesi nuk ka ofruar as një deklaratë apo formular që të mbështes pretendimet e tij, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apellesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të theksuara në apel dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të bazuara nga se nuk gjejnë mbështetje në prova konkrete.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

**Anr.1045/2021 më datën 07.11.2021**



**Kryesues i Panelit**

**Burim Ademi**

***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.